

KONSENSUSI JURIDIK ISLAM DHE EFEKTI I TIJ NË EVITIMIN E POLARIZIMEVE TE MYSLIMANËT

Konsensusi i dijetarëve islamë (el Ixhma'u) dhe pozita e tij në rangun e burimeve argumentuese të normave islame nuk është një temë e re. Ajo, si e tillë, ka zgjuar vëmendjen e shumë prej autorëve klasikë dhe bashkëkohorë dhe ka qenë temë rreth së cilës s'është kursyer aspak ngjyra e penave të tyre, ndaj edhe është shkruar shumë rreth saj. Nga dijetarët e mëhershëm që kanë bërë përpjekje që të përmbledhin të gjitha çështjet rreth të cilave kishte konsensus shkencor islam, ishte dijetari i njohur Ibn Mundhiri, e pas tij Ibn Abd El Berr e të tjerë, të cilët shkruan libra me titullin "El Ixhma'u-konsensusi juridiko-shkencor islam". Në fokus të shtjellimit tonë, nuk janë as numërimi dhe as përmendja e atyre çështjeve që ka konsensus rreth tyre, ngase një gjë e tillë duhet bërë në literatura më të zgjeruara dhe në punime të tjera shkencore. Ky punim dhe kjo analizë e natyrës kritike, më shumë fokusohet të kristalizojë rolin dhe efektin që do kishte unanimiteti i dijetarëve në shmangien dhe eliminimin e polarizimeve dhe divergjencave konfliktuale të myslimanëve në çdo kohë. Natyrisht, punimet e tilla nuk synojnë që të stërhollojnë diskutimet rreth një tematike aq me vlerë në periudhën aktuale. Për më tepër, një trajtim i tillë ka për synim që të provokojë ndërgjegjen tonë dhe të na bëjë edhe më kërkues e shumë më këmbëngulës, që të silltet në jetë përsëri ai unanimitet dhe konsensus, i cili ka ekzistuar te brezi i parë i dijetarëve të Islamit, andaj edhe si i tillë mund të rikthehet përsëri. Motivi i këtij hulumtimi sa është i natyrës shkencore, po aq përbën edhe një shqetësim për një realitet tonin, e cili, me pajtimin e të gjithëve, lë shumë për të dëshiruar.

Termi i konsensusit juridiko-shkencor islam

Në literaturën e shkencës së "Bazave të Jurisprudencës Islame-*Usuli Fikh*", konsensusin e gjejmë të emërtuar me shprehjen "*El Ixhma'u*". Në etimologji, kjo fjalë si paskajore ka domethënie dykahore: kompaktësinë, unanimitetin në një aspekt, por edhe vendosmërinë dhe ndarjen e mendjes

për të vepruar për diçka, në aspektin tjetër.¹ Ndërsa te dijetarët e “Bazave të Jurisprudencës Islame”, konsensusi- *El Ixhma’u* është:

*“Unanimiteti i dijetarëve hulumtues dhe eminentë (muxhtehidëve) nga umeti i Muhamedit (a.s.), pas vdekjes së tij, për ndonjë çështje të lindur, në ndonjërin prej periudhave kohore”.*²

Ky është vetëm njëri prej atyre përkufizimeve të këtij burimi të normave juridike islame. Varësisht nga kriteret që kanë vendosur dijetarët për realizimin e tij, variojnë pastaj përkufizimet e tyre. Natyrisht, do të mjaftohemi me këtë përkufizim që theksuam, ngaqë e shohim se ai është më përmbledhësi dhe jep për lexuesin perceptimin e drejtë e të plotë rreth konsensusit juridik islam.

Ky përkufizim rrëfen qartazi se konsensusi nuk ekzistonte dhe as nuk kishte nevojë të ekzistonte, gjatë kohës sa ishte gjallë i Dërguari i Allahut. Muhamedi (a.s.), i ndihmuar kryekëput me shpallje hyjnore nga Zoti i tij, mbulonte dhe përmbushte të gjitha kërkesat legjislative të komunitetit përreth tij. Libri i tij që u quajt “Kurani” dhe vetë ai me fjalët e veprat e tij, ishin autoriteti që përbënin referencën bazike për secilën problematikë që do të paraqitej asokohe, dhe jo vetëm.

Konsensusi juridiko-shkencor, duhet perceptuar se bëhet i plot-fuqishëm, vetëm nëse deri tek ai kanë arritur elita e dijetarëve eminentë, të cilët kanë njohje dhe posedojnë përgatitje të lartë shkencore³, që iu mundësojnë atyre të zhvillojnë hulumtime të pavarura shkencore në fusha të ndryshme islame. Shto kësaj, edhe atë tiparin e besimit të kulluar, si dhe shumë virtyte të tjera etiko-morale islame, pa përmbushjen e të cilave, të tillët nuk do të mund ta fitonin kurrë besimin e masave të gjera të myslimanëve. Madje, në rast të mosplotësimit të këtyre kriterëve, as nuk konsiderohen të denjë që të bëjnë hulumtime të thella, as meritore që të japin përgjigje për shetësimet e përditshme të individëve e të shoqërisë ku ata jetojnë. Misioni i tyre është i vështirë, andaj edhe kriteret e tyre janë tejet specifike e të larta.

Nga i njëjti përkufizim, vërehet se konsensusi mund të imagjinohet vetëm në rast të ekzistencës brenda një periudhe kohore, të një numri

1 *El Ensarij, Ibn Mendhur, Lisanu El Arab (8/67)*. Bot. i tretë, *Daru Sadir*, Bejrut, 1993.

2 *Ez Zerkesbij, Bedruddin, El Bahr El Muhiit (6/380)*. Bot. i parë, *Dar El Ketbij*, Aman, 1994.

3 P. s.: Këto kriteret dhe njohjet e larta shkencore janë të detajuara dhe të sqaruara një nga një, në literaturën bazike të shkencës së “Bazave të Jurisprudencës Islame”, por ato nuk janë në fokus të hulumtimit tonë, ndaj nuk e shohim të nevojshme të bëjmë shtjellimin e tyre këtu.

(shumës) të dijetarëve të këtij rangu të lartë. Ata në cilëndo rrethanë, duhet të jenë më shumë se tre.

Pozita e konsensusit juridiko-shkencor në rangun e burimeve juridike islame

Konsensusi apo unanimiteti shkencor i dijetarëve që i përkasin klasit ekskluziv e të lartë, në ranglistën e burimeve apo bazave të jurisprudencës islame, llogaritet i treti në radhë. Ai vjen pas Kuranit Fisnik dhe Sunetit profetik të Muhamedit s.a.v.s, dhe, në fund të fundit, iu referohet atyre të dyve. Shumica absolute e dijetarëve e konsiderojnë konsensusin, sidomos atë deklarativ (nëse dijetarët në mënyrë deklarative janë pajtuar për ndonjë çështje), si burim dhe argument i prerë, nga i cili mund të gjenerojnë norma të detajuara juridike, po sikurse që mund të gjenerojnë edhe nga dy burimet tjera para tij, që janë Kurani dhe Suneti. Juristi i mirënjohur hanefit, Ebu Bekr El Xhessas, e theksonte fuqinë argumentuese të konsensusit në normativat islame, duke thënë:

*“Konsensusi është argument-burim normativ i prerë që nuk lejohet kurrësi kundërshtimi i tij, e as nuk lejohet që të bëhet përpjekje për ndonjë hulumtim shkencor-ixhtihad paralel që do t'i bënte konkurrencë atij”.*⁴

E tërë kjo fuqi argumentuese iu atribua konsensusit shkencor islam, ngaqë kemi edhe një referim profetik që thekson qartazi pagabueshmërinë e atyre vendimeve që dalin si rezultat i konsensusit të elitës së dijetarëve islamë. Muhamedi a.s. kishte thënë:

*“Umeti im nuk kanë mundësi që të dakordohen për diçka që ata i shpie në lajthitje”.*⁵

Ky hadith, siç vërehet, nuk ia ka garantuar pagabueshmërinë cilitdo prej individëve të shoqërisë islame, qoftë ai i devotshëm apo edhe dijetar. Mirëpo, hadithi ka siguruar një gjë, e që është shumë me peshë për shtjellimin tonë, se nëse myslimanët bien në ujdj për një çështje, ajo kurrë nuk ka mundësi që të jetë humbje, të sjellë devijim apo të shkaktojë lajthitje për ta. Ujdia dhe konsensusi i tërë myslimanëve mund

4 *El Xhes sas, Ebu Bekr, El Fusul fi El Usul* (3\165). Bot. i dytë, Ministria për Çështjen e Vakëfeve dhe e Çështjeve Fetare e Kuvajtit, Kuvajt, 1994.

5 Evidenton Ibn Maxheh, në “*Sunen*” të tij (nr.: 3951) e të tjerë. Hadithi ngrihet në shkallë të originalitetit, përmes të gjitha rrugëve të transmetimit.

të imagjinohet vetëm kur paraprakisht bien në ujdi dhe pajtohen dijetarët e tij. Ata janë prijësit dhe unifikuesit e shpresuar në cilëndo shoqëri. Ujdia apo unanimiteti i dijetarëve është argument, madje argument i prerë normativ. Atë dhe dispozitat që rrjedhin prej tij, nuk lejohet që askush t'i thyejë, apo t'i nëpërkëmbë. Nisur nga ky rrafsh, dijetarët eminentë, si El Amidij, pastaj edhe Ebu Hamid El Gazali e të tjerë, e konsiderojnë atë si një prej bazamenteve më madhore të jurisprudencës islame. Ndërsa Esh Shirazi, njëri prej juristëve të shquar të shkollës juridike shafiite, vjen deri te një konstatim goxha i guximshëm, duke thënë:

“Nëse veç verifikohet se konsensusi i dijetarëve është argument juridik, atëherë duhet të konstatojmë se atij i jepet më shumë prioritet argumentues sesa hadithit ahad,⁶ edhe më shumë sesa hadithit mutevatir⁷, madje edhe më shumë se sa tekstit kuranor. Sepse, nëse eventualisht kemi një konsensus të dijetarëve në ndonjë rast në kundërshtim me tekstin, kjo i bie se ata e kanë kuptuar që tekstit të tillë vetëm se i është anuluar vlefshmëria i tij normative”⁸

Ky i fundit, nuk dëshironte të theksonte që teksti i prerë kuranor, i cili s'përmban mundësi alternative të interpretimit (kat'ij) duhet të lihet anash, pastaj të veprohet me konsensusin juridik islam. Ai i jepte përparësi konsensusit vetëm përballë atij teksti që në aspektin semantik është shumëkuptimor dhe elastik, përderisa dihet që mirëkuptimi është vendimtar dhe nuk ka mundësi të interpretimit në të. Ngjashëm sikur Shirazi, gjejmë disa prej studiuesve që bëjnë tentativë serioze që konsensusit (El Ixhma'u) t'i atribuojnë një lloj petku të shenjtërisë, por me një analogji më ndryshe. Këtë e bënë vetëm në kuptim të moslejimit të shkëljes apo nëpërkëmbjes së tij. Juristi dhe apologetiku i mirënjohur Ibn Akili, ishte njëri prej tyre, i cili bënte një analogji surrealistike duke thënë:

“Çdo përpjekje hulumtuese shkencore (ixhtihad) është e ndërtuar mbi konsensusin e dijetarëve të mëhershëm (El Ixham'u), çdo konsensus është i mbështetur në Kuran, e Kurani është shpallje

6 Hadithi *ahad* është ai hadith që në tri brezat e parë të zinxhirit transmetues është transmetuar nga një ose dy transmetues. Për origjinalitetin e këtij hadithi është diskutuar gjatë nga dijetarët e fushës së hadithit, por edhe të Usuli Fikhut.

7 Hadithi *mutevatir* është ai hadith që në tri brezat e parë është transmetuar nga një numër i madh transmetuesish (gjithsesi, më shumë se tre), në formë zinxhimore e të pashkëputur, jashtë imagjinitës që një grumbull aq i madh njerëzish të bien në ujdi për të thënë diçka të pavërtetë.

8 *El Xhessas, Ebu Bekr, El Ixhma'u* (f. 17-18). Bot. i parë. *Daru El Munteh'ab*, Bejrut, 1993.

*hyjnore. Shpallja hyjnore është e mbështetur në mrekulli (mu'xhize), ndërsa çdo mrekulli insiston që të dëshmojë se ekziston Një Krijues, e i cili kurrë nuk do ta mbështeste me mrekulli dikë (profetin), nëse Ai do ta dinte se Profeti do të ishte gënjeshtar”.*⁹

Natyrisht, mendimet e Shirazit, e afërsisht, edhe të Ibn Akilit, iu nënshtruan një kritike të thellë shkencore nga eruditët e këtij fahu, për shkak se krijuan përshtypjen se konsensusit të dijetarëve (të cilët tek e fundit janë njerëz dhe të gabueshëm) po i vishet një lloj petku i shenjtërisë, përballë tekstit kuranor, apo atij profetik që ka burim hyjnor. Edhe sjellja e mendimeve të tilla nuk nënkupton tek e fundit, pajtueshmërinë tonë me qëndrimet e tilla, por synon që të kristalizojë se deri në ç'masë e kanë ngritur vlerën dhe pozitën argumentuese të këtij burimi juridik shumë nga kolosët e Islamit.

Gjenealogjia e konsensusit juridiko-shkencor dhe nevoja e çdo brezi për të

Idea që dikush nga dijetarët e myslimanëve të atij brezi (sahabëve) duhet të ulet e të pajtohet për ndonjë çështje, nuk ekzistonte fare në epokën profetike të Muhamedit a.s. Natyrisht, ishte ai që garantonte një unitet të tillë mbarëshoqëror dhe ishte ai që ofronte kurën për plagët e shoqërisë me të cilën ai jetoi. Me vdekjen e tij, problematikat vetëm sa u rritën dhe preokupimet e njerëzve vetëm sa u shtuan. Ata nuk e kishin më strehën, nën hijen e së cilës e ndienin veten të qetë. I Dërguari i Zotit nuk jetonte më me ta. Mungesa e tij, natyrisht nuk mund të zëvendësohej lehtë. Për këtë, pajtoheshin të gjithë. Megjithatë, atyre iu nevojitej që shtegdaljet juridike të vazhdonin t'i gjenin nën hijen e po të njëjtit burimi hyjnor, tek i cili ishin referuar gjithmonë. Ata s'pranuan alternativë tjetër që do ta ndryshonte këtë princip.

Edhe më tej se kaq, ata dëshironin që së paku për çështjet fundamentale të dëgjohej një zë dhe të aplikohet një vendim. Kështu, kur u ndodhte ndonjë e re, dijetarët nga brezi i sahabëve e më pas edhe i tabiinëve, së pari hulumtonin në referencën juridike bazike të Islamit, pikërisht në Kuranin fisnik. E nëse nuk e gjenin atje, shihnin në Sunetin profetik. E nëse, as Suneti profetik nuk ofronte për ta zgjidhje, kalifi mblidhte elitën e dijetarëve dhe kërkonte mendimin e tyre. Rëndom, mendimi i

9 *El Bagdadij, Ibn Akil, El Vadib Fi El Usul* (1\343), Bot. i parë, *Err Rrisaletu*, Bejrut, 1999.

tyre merrej si vendim juridik që s'mund të tejkalohet.

Një model të tillë të referimit me konsensus të dijetarëve të kohës e dha edhe kalifi i parë, pas vdekjes së Muhamedit (a.s.), Ebu Bekri (r.a.). Rrëfëhet në citate të transmetuara në rrugë të besueshme se kur shfaqej ndonjë problematikë për të dhënë gjykimin rreth saj, ai shihte së pari në Librin e Allahut, e nëse aty gjente bazë për gjykimin e tij, gjykonte me të. E nëse nuk gjente, shikonte në Sunetin e Muhamedit (a.s.), nëse gjente diçka, dhe gjykonte në bazë të tij. E nëse edhe aty i pamundësohej, i pyeste njerëzit:

*“A dini rreth kësaj çështjeje ndonjë gjykim nga i Dërguari i Allahut (a.s.), se si ai ka gjykuar? Ndodhte që të ngrihej ndonjëri e të thoshte, në këso situatë se Muhamedi a.s, ka gjykuar në këtë mënyrë ose në ndonjë mënyrë tjetër. E, nëse nuk gjenin diçka të tillë, ai i tubonte krerët-dijetarë dhe kërkonte këshillën e tyre, se si ata mendonin se duhej vepruar. E, nëse ata binin në ujdi, pra dakordësbeshin për ndonjë mendim, ai gjykonte në bazë të tij”.*¹⁰

Këtu dëshmohej një e vërtetë historike, por që ka peshë dhe vlerë të madhe juridike. Ajo e vërtetë e kristalizoi mirëfilli edhe gjenezën e kësaj baze juridike islame dhe tregon haptazi se konsensusi i dijetarëve zë fill që në periudhën e parë të udhëheqjes së kalifit Ebu Bekër (r.a.). Konsensusi, fuqishëm, që nga ajo kohë e më tej (që pas vdekjes së Muhamedit a.s.), zë vendin e vet në rangun e burimeve juridike islame. Ngjarje të tilla regjistroheshin edhe në epokën e udhëheqjes së Omer Ibn Hattabit. Njësoj sikurse edhe paraardhësi i tij, Omeri (r.a.) do t'i jepte disa udhëzime gjykatësit të famshëm, Shurjh El Kadi, të cilin vetë e kishte emëruar në atë pozitë. Brenda atyre udhëzimeve, del edhe porosia e tij për ruajtjen dhe mbështetjen në konsensus të dijetarëve të mirëfilltë islamë. Ai iu drejtua gjykatësit, duke i thënë:

*“Nëse të vjen ndonjë çështje për të gjykuar, ti gjyko me atë që është në Librin e Allahut, e nëse nuk gjen, gjyko me atë që e ka lënë pas vetes i Dërguari i Allahut (a.s.) (nga hadithet dhe tradita e tij), e nëse as aty nuk e gjen, atëherë gjyko në bazë të asaj që kanë rënë në ujdi (konsensus) njerëzit (p.s. synonte dijetarët, natyrisht)!”*¹¹

10 Këtë rast e evidenton Darimiu në “Sunen” e tij (1\58), pastaj Darukutni në “Es Sunen El Kubra” (10\114). Shih detajet e kësaj ngjarjeje në librin e Ibn Kajjim El Xhevziut “I’lam El Muvekkil’in” (2\115), Bot. Daru Ibn Xhevzij, Rijad, 2002.

11 El Xhessas, Ebu Bekr, El Ixhma’u (f. 18). Bot. i parë, Daru El Munteh’ab, Bejrut, 1993.

Omeri në këtë shkresë-dekret ishte ndoshta tejet i drejtpërdrejtë dhe dha urdhër që menjëherë pas shqyrtimit të dy burimeve bazike juridike prioritare, ai duhet të referohej në konsensusin juridiko-shkencor të elitës së dijetarëve, e të cilin kurrsesi nuk duhet tejkaluar.

Pra, nëse gjatë periudhës profetike, sahabëve të tij, iu duhej të mbështeteshin në tri prej burimeve të besueshme të dispozitave juridike islame (Kuran, Sunet, Analogji-Kijas), pas vdekjes së Muhamedit a.s. shihet nevoja që të shtohej edhe një bazë e fuqishme e normave juridike. E këtë vend do ta zinte me të drejtë konsensusi (el ixhmau) i dijetarëve islamë. Ai qe një bazë argumentuese suplementare, që doli në skenën juridike që në fazën fillestare të degëzimit dhe të detajimit të platformës juridike islame.

Roli i konsensusit të dijetarëve në ruajtjen e unitetit të myslimanëve

Ishin çastet e para menjëherë pas vdekjes së Muhamedit (a.s.), kur kërkohej nga shokët e tij të cilët i la pas vetes, jo vetëm një ndërgjegje dhe vetëdije e lartë fetare dhe shkencore, por edhe pjekuri e maturi e skajshme politike dhe shoqërore. Muhamedi a.s. në të gjallë të tij, përveç faktit që ishte i Dërguar i Allahut, mbante edhe pozitën e udhëheqësit të shtetit islam. Ai shtet qe formuar menjëherë pas shpërnguljes së tij në Medinë. Por, me vdekjen e tij, njëra prej këtyre dy detyrave që i bartte ai, do të ndërpritej përgjithmonë. Kjo detyrë ishte profetësia. S’kishte më të dërguar tjetër pas tij. Natyrisht që nuk duhej bërë kurrfarë përpjekjeje që ai mision të ripërtërihej, në kuptim të pritjes së ndonjë shpalljeje tjetër nga qielli. Ishte punë e kryer tashmë. Mirëpo, detyra e tij prej udhëheqësi politik në shtetin islam s’duhej lënë vakant. Andaj shokët e tij, apriori, ata që ishin të njohur për vetëdijen dhe inteligjencën e rrallë, por edhe për gatishmërinë që të qëndronin në ballë të proceseve të rënda, morën një vendim që për kohën llogaritej tejet i guximshëm, por njëkohësisht edhe delikat. Ata vendosën të vonojnë edhe varrosjen e trupit të pajetë të të dashurit të tyre, Profetit Muhamed (a.s.), për disa arsye, por që më thelbësorja ishte se pozita e tij vakante, prej udhëheqësi politik të myslimanëve duhej të zëvendësohej, para se të mbulohej trupi i tij me dhe. Ata u mbyllën në vendin e quajtur “Sekifete Beni Sai’dete”, e nuk dolën nga ai vend pa një konsensus të mbyllur e unifikues (edhe pse kishin mbetur tejet pak nga sahabët që nuk e dhanë betimin e pajtimin

për Ebu Bekrin si kalif, atë ditë, deri diku pas gjashtë muajsh ose edhe më pak, rrëfëhet se edhe ata e bënë të njëjtën gjë). Diskutimet ishin të gjata dhe të vështira, por epilogu, pa dyshim ishte i lavdishëm. Aty vendoset që Ebu Bekr Es Siddiku të jetë zëvendësuesi politik dhe fetar i Muhamedit (a.s.), apo kalifi i parë pas tij. Vonesën e varrosjes së të Dërguarit (a.s.) me justifikimin e gjetjes së kalifit unifikues, e mendojnë si arsye thelbësore një numër jo i vogël i hadithologëve dhe historiografëve. Neveviu ishte njëri prej tyre, i cili lidhur me këtë çështje këmbëngulte duke thënë:

“Ata vërtetë e vonuan varrosjen e tij që nga dita e hënë (kur ai vdiq) deri në mbrëmjen e ditës së mërkurë, për shkak të angazhimit të tyre rreth gjetjes së zëvendësuesit-prijësit mysliman pas tij si dhe dhënies së besës për atë prijës të ri (be’ah). Kjo bëhej që të ruhej uniteti i fjalës së tyre dhe të ruheshin vetë ata, që të mos vinin deri te konflikti. E kjo, pa dyshim se ishte çështja më me peshë”.¹²

Kjo ndodhi e regjistruar në historinë e lavdishme të brezit të parë të myslimanëve, rrëfen për më tepër qartësinë e vizionit të tyre dhe njohurinë e thellë që ata kishin për “konceptin e prioritetëve”. Ai brez, në një periudhë tejet të hershme, përvijoi një rrugëtim të mirëfilltë për gjeneratat e ardhshme, por që realiteti i mëvonshëm dëshmoi se ne brezat që erdhëm, nuk i morëm tërësisht si të mirëqena leksionet e tij. Uniteti i shokëve të Profetit Muhamed (a.s.), u ruajt falë Zotit, por edhe falë aftësisë së krerëve të urtë e të ditur të tyre, si dhe falë gatishmërisë që ata treguan që të sillnin një konsensus para masave myslimane. Ata e gatuan një konsensus elitar prej eruditësh (el ixhma’u), i cili do të përbënte tharmin e unitetit për një periudhë kohore jo të shkurtër. Zërat kundërshtues që u dëgjuan aty-këtu, e që shprehnin pakënaqësinë e ndonjërit prej tyre që Ebu Bekri të mbetej mëkëmbës-kalif i myslimanëve pas vdekjes së Profetit Muhamed (a.s.), pothuajse u shuan. Ata zëra, pas atij konsensusi, heshtën për të ruajtur atë unitet që atëherë dhe gjithmonë do të mbetet jetik.

Natyrisht që pranohet unanimisht, se, pas vdekjes së Profetit, vakuumi shpirtëror ishte i madh, meqë në cilësinë e tij prej të dërguari ai mbetet i pazëvendësueshëm. Megjithatë, dijetarët, si trashëgimtarë të denjë (por jo gjithsesi idealë) të misionit profetik, pastaj të urtit, e në veçanti udhëheqësit politikë myslimanë, do të ballafaqohen me situata të reja të papërrjetuara më parë. Në sfidën e ruajtjes së unitetit të shoqërisë në periudhat në vijim, ata do të detyroheshin që të riktheheshin në burimet e

unitetit të pathyeshëm që mbretëroi për shumë kohë. Ata bënë përpjekje që të ofronin pastaj një platformë, me anë të së cilës do të garantohej ruajtja e shoqërisë islame nga polarizimet dhe plasaritjet, me gjasë të pashmangshme gjatë gjithë viteve dhe shekujve në vijim.

Njëra prej pikave më të rëndësishme, por jo e vetmja, e që ofronte një shkëndijë shprese për të ruajtur atë unitet dhe për të kultivuar atë kohezion mbresëlënës që mbretëronte për vite me radhë, do të mbetet pa dyshim edhe konsensusi elitar i dijetarëve islamë rreth problematikave të ndryshme. Ata dijetarë të cilët pritet se do të sjellin konsensusin për problemet e dilemat më delikate, janë përshkruar nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi (a.s.) me fjalë mjaft domethënëse:

*“Diturinë e kësaj feje, në secilin prej brezave që vijnë pas meje, do ta bartin ata dijetarë të drejtë, të cilët i shmangin dhe mënjanojnë nga ky umet devijimet e ekstremëve, adoptimet e gabuara (përvetësimet) të gënjeshtarëve, dhe interpretimet e injorantëve”.*¹³

Nga ky hadith kuptohet që misioni i dijetarëve të vëmendshëm që merren me çështjet dhe problematikat e myslimanëve shtrihet në rrafsh të shumta. Në njërin anë, kërkohet prej tyre që t'i shmangin devijimet e atyre njerëzve që kanë prirje që gjërat t'i kapin në skajshmëritë e tyre në ekstremitete. Në anën tjetër, ata duhet të qartësojnë qëndrimet e Islamit në lidhje me shpifjet dhe gënjeshttrat e gënjeshtarëve, që flasin në emër të tij ose kundër tij, e të cilët kanë tendenca dashakeqe kundër kësaj feje dhe myslimanëve. Rrafshi i fundit në të cilin duhet të veprojnë ata, është që ta vetëdijësojnë masën e t'ia tërheqin vërejtjen për rrezikun e rënies pre të interpretimeve të gabuara që vijnë nga injorantët të cilët flasin në emër të fesë e që nuk e njohin atë fare. Secila nga këto tri misione, me të cilat Muhamedi (a.s.) i ngarkoi dijetarët e denjë, është një barrë e rëndë të cilën do të duhej ta kryenin më përkushtim të skajshëm. Mungesa e përkushtimit të tyre, lë hapësirë që timonin e orientimit të umetit islam nëpër kohëra të ndryshme të sfidave dhe krizave, ta marrin ata njerëz që s'munden as për vete t'i parashikojnë pasojat e veprimeve të tyre të gabuara.

Në këtë linjë, duhet pranuar se një vrojtim i shkurtër i realitetit të shoqërive islame, në cilëndo pjesë të globit, na sjell pamje të ndryshme të plasaritjeve, polarizimeve, e jo rrallë edhe të konflikteve të myslimanëve. Këto përshkrime objektive, tashmë, nuk përbëjnë lajm për askënd. Zëri

13 Shih: *El-Menavij, Fejdule Kadir* (6/396), *El Mektebetu Et Tixharijetu El Kubra*, Egjipt, 1989.

i tyre i venitur dhe i lodhur nga plasaritjet për çështjet më të thjeshta e joparimore, kumbon në veshët e dijetarëve islamë, duke kërkuar prej tyre një zë, një fjalë e një qëndrim unik. Pa atë “njëshin” e çmueshëm të tyre në qëndrime, nuk arrihet as “njëshi” e kompaktësia e të tjerëve që i mbajnë sytë në drejtim të tyre.

Një pengesë që nuk ishte e lehtë të tejkalohet në kohërat e hershme dhe që e vështirësonte edhe arritjen e konsensusit në mes të dijetarëve, ishte edhe shpërndarja e tyre fizike nëpër vise e rajone të ndryshme dhe të largëta. Kishte vështirësi që një dijetar i Kufës, të takohej me atë të Mekës apo të Medinës. Ashtu siç kishte vështirësi që një erudit i Egjiptit të takohej me një të ngjashëm nga Shami. Pikëtakimi më i lehtë, edhe pse jo i shpeshtë i tyre, ishte Meka. Ai takim realizohej rëndom gjatë kohës së Haxhit. Meka e shenjtë, ishte ajo që mundësonte bashkimin dhe takimin e tyre.

Mirëpo në epokën bashkëkohore, rrugët dhe mjetet e komunikimit janë lehtësuar për të gjithë, dhe më të lehta do të duhej të ishin për shkencëtarët e dijetarët e fushave të ndryshme, gjithsesi edhe ata të fushave studimore islame. Lehtësia dhe shumësia e mjeteve të komunikimit, sot, sjell mbi supet e dijetarëve islamë edhe peshën e rëndë të amanetit të shenjtë të unifikimit e kompaktësisë të shoqërisë islame. Ajo do të duhej të realizohej së paku rreth fundamenteve bazike islame. Në çështjet bazike që prekin thelbin dhe ajkën e parimeve islame, bartësit elitare të dijeve islame duhet të jenë të gatshëm dhe të kenë guximin, ashtu siç bënë ata të brezave të mëhershëm, që të sjellin edhe vendime e qëndrime konsensuale, me anë të të cilave do të mbyllin rrugën e polarizimeve të shoqërive islame kudo nëpër botë.

Në këtë frymë, duhet konceptuar një herë e mirë se, misioni i dijetarëve të mirëfilltë nuk përfundon me deklaratimet dhe prononcimet e tyre individuale nëpër media, apo me shkrimet a “cicërimat” e ngjeshura nëpër rrjetet e ndryshme sociale. Prej tyre, në çdo rrethanë dhe kohë, do kërkohet ofrimi i zgjidhjeve, qoftë edhe në formë opinionesh juridike individuale (fetva), për secilin shqetësim që mund ta ketë cilido prej individëve të shoqërisë islame. Kërkohet që ata të bëjnë hulumtime dhe analiza të thella shkencore e juridike në veçanti, që myslimanët të mos mbeten pa zgjidhje juridike islame, për secilin problem me të cilin ata ballafaqohen. Elementi më i vlefshëm dhe më i rëndësishëm është të gjejnë një truall të përbashkët dhe të dakordësohen me njëri-tjetrin për çështje që s’ka vend për divergjenca, larg çdo fanatizmi grupor apo individual. Pa këtë rol, amaneti nuk kryhet dhe përgjegjësia mbetet mbi supet e tyre deri në Ditën e Gjykimit.

Përfundim

Nga shtjellimi i tematikës sonë, arritëm në disa përfundime me vlerë për lexuesin, të cilat sigurisht që janë fryt i një punimi modest dhe i një analize shkencore në literaturën e besueshme islame. Këto përfundime mund t'i rendisim si në vijim:

- Ixma'i është burimi i tretë në ranglistën e shtyllave juridike islame. Ai mbetet njëri prej burimeve të pakontestueshme të normave e dispozitave praktike në Islam.
- Konsensusi juridiko-shkencor i elitës së dijetarëve nuk ka ekzistuar në periudhën profetike, për shkak sepse nuk kishte fare nevojë për të.
- Brezat e parë në historinë e myslimanëve, me vetëdijen e tyre të lartë islame, iu referuan burimeve tjera bazike, kur ata strukturuan një bazë të fuqishme juridike, siç ishte konsensusi elitar i dijetarëve të Islamit.
- Konsensusi i dijetarëve si në periudhat klasike ashtu edhe në ato të mëvonshme do të konsiderohet strumbullari dhe nyja kyçe e unitetit mbarëmysliman.
- Uniteti dhe kompaktësia e dijetarëve as sot e as nesër nuk konsiderohet si një luks, as një punë e dorës së dytë. Pa asnjë dilemë, realizimi i tij është domosdoshmëri imediate që s'pranon vonesë e as justifikim.

Bibliografia

1. *El Ensarij, Ibn Mendhur, Lisanu El Arab* (8/67). Bot. i tretë. *Daru Sadir*. Bejrut. Bejrut. 1993
2. *Ez Zerkeshij, Bedruddin, El Bahr El Muhiit* (6/380). Bot. i parë. *Dar El Ketbij*. Aman. 1994
3. *El Xhes sas, Ebu Bekr, El Fusul fi El Usul* (3\165). Bot. i dytë. Ministria për Çështjet e Vakëfeve dhe e Çështjeve Fetare e Kuvajtit. Kuvajt. 1994.
4. *El Bagdadij, Ibn Akil, El Vadih Fi El Usul* (1\343). Bot. i parë. *Err Rrisaletu*. Bejrut. 1999.
5. *El Xhevzi, Ibn Kajjim, I'lam El Muvekki'in*, (2\115). Bot. *Daru Ibn Xhevzij*. Rijad. 2002.
6. *En Nevevij, Sherh Sahih Muslim* (7/36). Bot. i dytë. *Daru Ihjau Et Turath El Islamij*. Bejrut. 1997.

7. *El-Menavij, Fejdul Kadir. (6\396). El Mektebetu Et Tixharijetu El Kubra.* Egjipt. 1989.
8. *El Xhessas, Ebu Bekr, El Ixhma'u* (fq. 17-18). Bot i parë. *Daru El Munteh'ab.* Bejrut. 1993.